REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 137/17
Datë/Datum. 29.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Komuna Viti"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr. 137/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti"**, me nr. të Prokurimit: **657/17/1097/221.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE- "Eco-Higjiena" sh.p.k**		
Datë	**29.05.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE: **"Eco-Higjiena" sh.p.k - Gjilan,** kundër AK – **Komuna Viti,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti"** me nr. të Prokurimit: **657/17/1097/221.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

		19.05.2017		**22.05.2017**		**29.05.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit:

Me datën **11.05.2017**, OSHP ka pranuar ankesën me nr. **137/17,** e parashtruar nga OE: **"Eco-Higjiena", sh.p.k – nga Gjilan**, kundër AK – **Komuna Viti,** lidhur me aktivitetin të prokurimit **"Shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti"** me nr. të Prokurimit: **657/17/1097/221**
Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Viti.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues: "Eco-Higjiena" sh.p.k-Gjilan.

Pikat e Ankesës nga OE **"Eco-Higjiena" sh.p.k-Gjilan.**

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 65-71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Poashtu Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 54 të Ligjit për Prokurimin Publik

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

1. Operatori ekonomik fitues QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K., sipas regjistrit për biznese të Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve në Prishtinë, është regjistruar në Agjensionin për biznese më datën 29.01.2016. Pretendimi i Autoriteti Kontraktues se Operatori Ekonomik fitues më herët ka vepruar me një numër tjetër biznesi dhe me numër tjetër fiskal, është plotësisht i gabuar, sepse sipas regjistrit të Agjensionit për Biznese, të cilat janë publike,i QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K. për herë të parë është themeluar në muajin Janar 2016 dhe jo më herët. Është e vërtetë se në Agjensionin për biznese janë të regjistruar dy biznese me emrin OENDRA KOPSHTARE N.P.SH. me mu mër të biznesit 30112831 dhe QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K. me numër të biznesit 71238121, por në këtë procedurë tenderuese ka aplikuar si biznes i vetëm vetëm QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K., e themeluar në vitin 2016.

2. QENDRA KOPSHTARE Sh.P.K. nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional (Pika III.2.4 e njoftimit për kontratë), më konkretisht:

a. Operatori Ekonomik fitues nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar për kontratat për

shërbime të njëjta në tri vitet e fundit; dhe

b. Operatori Ekonomik fitues nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuara për stafin e punëtorëve të punësuar në kompani, ku janë kërkuar së paku 20 të punësuar. Sipas shënimeve të Agjensionit për Biznese në Prishtinë, OE Fitues i ka të punësuar vetëm tre punëtor.

3. Operatori Ekonomik fitues objektivisht e kishte të pamundur që ta plotësonte kriterin e kërkuar për qarkullimin vjetor prej 100,000.00 Euro, për tre vite (për vitet 2014, 2015 dhe 2016), sepse sic e theksuam më lartë, OE fitues për herë të parë është themeluar në vitin 2016.

4. Operatori ekonomik fitues ka ofruar një tender të pazbatueshëm në kuptim të nenit 61 të LPP-së.

5. Autoriteti Kontraktues nuk na ka dërguar njoftimin për eleminim nga tenderi, por sic e kemi theksuar më lartë, në lidhje me elimimin e ankuesit, kemi kuptuar vetëm nga faqja zyrtare e KRPP-së.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 10.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Shërbime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,.....06.04.2017
Afati i parapare per hapje te ofertave, ...06.04.2017
Data e njoftimit per dhenje te kontrtes.....24.04.2017
Kriter për dhënien e kontrates:.....çmimi më i ulët

Kriteret për vlerësim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a) Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesen mbi përshtatëshmerin të ligjit të prokurimit nr. 04/L-042,neni 65.....Obligative.
b) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik , se opersatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tre mujorin e fundit para dorëzimit tëtenderi.....Obligative. (Vetëm për fituesin)
c) Vërtetimin e gjykates ekonomike.. Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që përmbush "kërkesat e përshtatshmërisë"(Të mos jetë më i vjetër se gjashtë muaj nga dorëzimi i tenderit). - Obligative. (Vetëm për fituesin)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a Deklarata nën betim, në dosje e vulosur dhe e nënshkruar.
c) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore – origjinal
d) c. Deshmi Vërtetimin e gjykatës ekonomike - origjinal ose kopje e noterizuar

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH-s
Kërkesa 3. Regjistrimi i Numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit

ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH-s Dëshmi
2. Kopja çertifikata e TVSH-së
Dëshmi 3. Kopja e Numrit fiskal;

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Raport mbi qarkullimin minimal 100,000.00 per tri vitet e fundit.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
1. KONTRATA PER SHERBIME TE NGJASHME, MINIMUM NJE KONTRATA NE TRI VITET E FUNDIT
2. 2. Një regjistër i mjeteve të afta të punëve në emrin e kompanisë , specifiko te gjitha sipas kategorive
3. Stafi i punëtoreve të punësuar në kompani, së paku 20 të punësuar, te prezentuar dhe vulosur nga OE
4.Menaxher i projektit inxh. i diplomuar, i caktuar me vendim te OE

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Një raport te konfirmuar mbi qarkullimin ne tri vitet e fundit 2014-2015- 2016.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Lista e kontratave te natyres se njejte te sherbimeve ose te ngjashme, minimu nje, bashkangjitur Referenca te sherbimeve ose Raporte pranimi, per vitet tri vitet e fundit (2014-2015-2016)
2. Lista e pajisjeve të kompanisë për kryerjen e shërbimit të kërkuar, min. dy (2) kamionë transporti për mbeturina,një (1) kamion(cisternë) për ujë, dhe një (2) kamionetë transporti ,fotot dhe librezat e regjistrimit si deshmi
3. Lista e te punësuarve ne kompani se paku 20,te vërtetuar nga kompania, basshke me parakontraten+CV ose te angazhuar dhe zotimin e OE se keta punetor do te jene te obligueshem per te mirembajte gjitha hapesirat publike sipas Paramases se ofertuar
4. Deshmi per menaxherin te sjell diplomen e inxh.te noterizuar, kontraten dhe CV.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €
1.	"Eco-Higjiena"	Gjilan	55,995.64 €
2.	"Qendra Kopshtare' sh.p.k	Kamenicë	42,220.66 €

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 06.04.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave nuk është paraqitur ndonjë vërejtje.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Driton Halabaku,
- - Anëtar i komisionit - Osman Osmani,
- - Anëtar i komisionit – Riad Sadiku,

Data e mbarimit të vlerësimit: .....19.04.2017.

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....19.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vleresues propozon për dhënjen e kontrates kompanise OE Qendra KOPSHTARE, me seli në Kamenic, si oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët .

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306) :

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1.

Autoriteti Kontraktues - **"Komuna Ferizaj"**, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim, kontratë publike me vlerë të mesme, vlera e parashikuar e kontrates 60,000.00€. OE ankues: EKO-HIGJIENA sh.p.k, ka parashtruar ankesë kunër Njoftimit për dhënien e kontrates të dt.24.04.2017, me pretendime ankimore: Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 65-71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Poashtu Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 54 të Ligjit për Prokurimin Publik

Pretendimi ankimor nr.2

Poashtu pretendimet e **OE** "EKO-HIGJIENA" sh.p.k, kanë të bëjnë me oferten e OE të rekomanduar për kontrat, se e njëjta është e papërgjegjshme sa i përket kërkesave të FDT-së dhe njoftimit për kontrat, konkretisht:

Pikës III. 2.4 kontrata për shërbime të njëjta në tri vitet e fundit 2014,2015 dhe 2016,

Eksperti shqyrtues, në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket pikës 9.1 dhe 9.2 të FDT, "lista e kontratave të natyres së njejtë shërbimeve ose të ngjashme, minimum një (1), bashkangjitur Referenca shërbimeve ose raporte pranimi, për vitet e fundit 2014,2015 dhe 2016.

Eksperti shqyrtues në lidhje me këtë pretendim ankimor vlerëson se qëndron për faktin se në ofertën e OE të rekomanduar për kontrat në ofertën origjinale OE ka ofruar listen e kontratave për shërbime të ngjashme, tri projekte të bashkangjitur referencat për këto projekte, në bazë të emrit të kompanis të përshkruar në referenca, Eksperti shqyrtues vlerëson se vetëm referenca e lëshuar nga KK Kamenicë, e dt.19.08.2016, nr.prot.27309, i përket OE Qendra Kopshtare" sh.p.k, e cila është në implementim e sipër, e papërfunduar, ndërsa dy referencat e tjera janë në emer të njëjti të Kompanis NPSH "Qendra

Kopshtare", e cila në bazë të gjeturave në ARBK është kompani e ndryshme nga Kompania ofertuese, duke u bazuar në atë se Qendra Kopshtare sh.p.k, është themeluar dhe rexhistruar në vitin 2016, poashtu pronari i kompanis është

1	Shehnaze Berisha
2	Rexhep Berisha

Eksperti shqyrtues mendon se Autoriteti kontraktues është i obliguar të verifikoj këto të dhëna në lidhje me referencat e ofruar nga OE i rekomanduar për kontrat sa i përket Kompanis NPSH "Qendra Kopshtare", për faktin se OE i rekomanduar ka ofruar vetëm një referenc të papërfunduar për shërbime të ngjashme.

Pretendimi ankimor nr.3,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket numrit të angazhuar në këtë projekt,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor për faktin se në kërkesën e FDT, pika 9.1 dhe 9.2, pika 3, është kërkuar: lista e të punësuarve në kompani së paku 20, të bashkangjitur me parakontrata, cv, dhe zotimin e OE se dot angazhoj në këtë projekt. Eksperti shqyrtues mendon se kërkesa e FDT, nuk obligon që të këtë në marëdhenie punë 20 punëtor, por obligon OE të ofroj parakontrata për këtë numër të punëtorve dhe në rast të nënshkrimit të kontrates të punësoj këtë numer të punëtoreve, në rastin konkret OE i rekomanduar për kontrat ka ofruar parakontrata për të punësuarit në harmoni me kërkesën e FDT-së dhe Njoftimin për kontrat.

Pretendimi ankimor nr.4,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së FDT-së dhe njoftimit për kontrat në lidhje me qarkullimin bankar në vlerë prejt 100,000.00€, në tri vitet e fundit 2014,2015 dhe 2016.

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor duke u bazuar në atë se OE i rekomanduar për kontrat ka ofruar qarkullim bankar në vlerë mbi 280,000.00€ vetëm për vitin 2016, njëherit kërkesa e FDT-së në lidhje me qarkullimin bankar është plotësuar nga ana OE të rekomanduar për kontrat.

Pretendimi ankimor nr.5,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës nenit 61 të LPP-së, ku pretendon se OE i rekomanduar për kontrat ka ofruar tender të pazbatushem në kuptim të nenit 61 të LPP-së,

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i pabazuar për faktin se OE ankues nuk ka ofruar asnjë provë në lidhje me çmimet e OE të rekomanduar për kontrat dhe nuk specifikuar asnjë çmimit konkret për ta arsyetuar pretendimin ankimore, në lidhje me këtë Eksperti shqyrtues vlerëson se mbetet përgjegjësi e Autoritetit kontraktues të vlerësoj çmimet në lidhje me këtë projekt për të cilen është i obliguar të bëjë vlerësimin e çmimeve sipas nenit 61 të LPP-së.

Pretendimi ankimor nr.6,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 54 të LPP-së, ku pretendon se nuk është njoftuar nga ana e AK-së, në lidhje me Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar.

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor duke u bazuar në atë se AK-ja nuk ka dërguar letër standarde Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar OE ankues në harmoni me nenin 54 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit:

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendoj që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vitis, për aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti", me nr. të Prokurimit: 657/17/1097/221, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. **Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të anuloj vendimin e AK-së, njoftimin për dhënje të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERESIM. ndërsa pretendimet ankimore të OE EKO-HIGJIENA", të aprovohën si pjesërisht të bazuara.**